



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

	REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA	
0201-052/01-0041496/76		
Data: 17.07.2026		
Shtet: Mitrovicë - Mitrovica		

RAPORT GJASHTËMUJOR 2026

Mitrovicë, Korrik 2026

Përmbajtja:

-DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

-Aktivitetet e rregullta të Drejtorisë,

-Aktivitetet në kuadër të realizimit të projekteve,

-Aktivitetet e bashkëpunimeve.

-Foto nga Aktivitetet e realizuara

-OBJEKTIVAT

-PERMBLEDHJE

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Ky raport përmban analizën e rezultateve, aktiviteteve dhe projekteve të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural lidhur me mbështetjen e fermerëve nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me MBZHR-në, organizatat vendore dhe ndërkombëtare në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Duke u bazuar në planin e punës dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe me kërkesat e fermerëve në bashkëpunim me MBZHR-në gjatë periudhës gjashtëmujore janë realizuar një numër i madh i aktiviteteve dhe projekteve ku nëpërmjet përkrahjes dhe mbështetjes së fermerëve do të realizohen projektet dhe aktivitetet në planin e punës, me qëllim të rritjes së zhvillimit të Bujqësisë në sektorë prioritar si: Blegtori, Pemëtari, Perimtari, Bletari, Lavërtari etj.

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është e përbërë nga një staf profesional i cili angazhohet për të kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese bujqësore të fermerëve, të shpërndajnë njohuri dhe praktika më të mira të prodhimit bujqësorë duke zbatuar politika dhe projekte që i kontribuojnë zhvillimit rural në komunën tonë, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg.

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të fushëveprimtarisë së saj mbrenda kompetencave dhe përgjegjësisë që i takojnë gjatë këtijë gjashtëmujori në bashkëpunim me MBZHR-në ka kryer aktivitetet kryesore që janë zhvilluar në drejtime të ndryshme:

I. Aktivitetet e rregullta të Drejtorisë,

II. Aktivitetet në kuadër të realizimit të projekteve,

III. Aktivitetet e bashkëpunimeve.

I . Aktivitetet e rregullta të Drejtorisë

- Planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave pranverore,
- Hartimi i propozim-projekteve për sektorë të ndryshëm: Sektori i perimtarisë (ngritja e serrave), sektori i mekanizimit bujqësorë (pajisje për të gjithë sektorët), sektori i blegtorisë, (pajisje për bletari), sektori i pemëtarisë (ngritja e siperfaqëve me fidane lajthi dhe arra) etj,
- Angazhimi i stafit të Drejtorisë së Bujqësisë për regjistrimin e aplikimit dhe digjitalizimit në sistemin për pagesa direkte për vitin 2026, ky regjistrim është duke u realizuar me sukses deri në afatin e caktuar 21(njëzet e një) korrik me mundësi shtyerje,
- Promovimi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, organizim i panairove për prodhime dhe produkte vendore, prezentim i raporteve etj.
- Monitorimi i fermerëve që merren me prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura,
- Udhëzime për fermerë dhe ndihmë për të aplikuar në grante të ndryshme etj,
- Aktivitete, takime zyrtare, si dhe pjesëmarrja në takime zyrtare, vizita në teren nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

-Takim me Drejtorin e Shoqatës joqeveritare "Pe Pe Ko" që merrët me përpunimin e pemëve dhe perimëve në Kosovë,

- Takim me drejtorin e Qumështores ALDI për bashkpunim dhe për mbështetje të fermerëve që merren me prodhimtari të qumështit,

- Takim me Drejtoreshën e Agjencionit për Zhvillim Rajonal në Veri "RDA "për mbështetje të fermerëve si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit rural,

- Takim me Drejtoreshën e IBCM-it për forcimin e bashkëpunimit dhe mundësinë e mbështetjes së zhvillimit të sektorit të bujqësisë,

- Takim me Drejtoreshën e DIAKONI-së, me qëllim të bashkëpunimit dhe krijimin e mundësive për trajnime profesionale për fermerë,

- Aktiviteti për projektin "Fuqizimi i Grave në Zonat Rurale të Kosovës" i implementuar nga FAO dhe UN Women dhe e financuar nga ADA i cili është zbatuar në tri komuna: Mitrovicë e Jugut, Istog dhe Skënderaj, në kuadër të këtij projekti janë mbajtur trajnime shtatë ditore në-

objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, ku kanë marrë pjesë në trajnim 28 gra fermere të cilat përveç trajnimeve kanë përfituar pajisje të ndryshme bujqësore, varësisht prej aplikimit, kontratat për përfitimin e pajisjeve i kanë nënshkruar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe pajisjet bujqësore fituese janë shpërndarë në hapësira publike, ku shpërndarja u realizua në prezencën e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut z. Faton Peci, ku në kuadër të këtij projekti përmbyllës u organizua edhe panairi i grave fermere në qendër të qytetit të Mitrovicës së Jugut.

- Takimi me përfaqësues të Shoqatës së Bletarëve,

- Takimi me përfaqësues të fshatërave të Komunës së Mitrovicës së Jugut me qëllim të identifikimit të nevojave kryesore për përmirësim dhe rritje të qndrueshme të prodhimit,

- Takimi me Gra fermere me qëllim të identifikimit të sfidave dhe fuqizimin e rolit të tyre në Bujqësi,

- Takim i Kolegjiut të Drejtorëve Komunal për Bujqësi i organizuar nga ECO Kos Women dhe Caritasi Zvicëran.

- Pjesëmarrje në takime dhe prezente të ndryshme zyrtare dhe të tjera.

- Aktivitete të tjera të DBZHR-së:

- Angazhim në Programin e Shërbimeve Këshillore të DBZHR në bashkëpunim me MBZHR,

- Regjistrimi i fermerëve në regjistrin elektronik të fermerit në EFR,

- Lëshimi i NIF - ave për fermerët e rinjë,

- Planifikimi dhe Hartimi i kriterëve për projektet sipas planit të punës së DBZHR-së,

- Takime me OJQ vendore dhe ndërkombëtare për bujqësi,

- Takime të rregullta me fermerë në zyrë dhe vizita të rregullta në teren sipas kërkesave të fermerëve dhe projekteve të planifikuara sipas planit 2026.

II. Aktivitetet në kuadër të realizimit të projekteve

- Projektet të cilat janë realizuar dhe ato që janë në proces të realizimit në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026:

Projektet:	Mënyra e Pagesës:	Faza e Realizimit Totali:	Numri i Perfitueseve:
Organizimi i Panairit "Konaku i Mitrovicës" dhe aktivitetet tjera promovuese	DBZHR	6,230€ Në proces	21 (njëzet e një)
Marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrjen N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A	DBZHR	35,000€ E realizuar	-
Përkrahja e fermerëve me kredi bujqësore (interesi bankar)	DF	30,000€ Në proces	-
Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësorë	DBZHR	74,000€ Në proces	-
Përkrahja e fermerëve me serra të tipit tunel 50m ² dhe 100m ²	DBZHR	48,000€ Në proces	-
Kompenzimi i dëmeve për fermerët e dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore	DBZHR	5,000€	-

- Subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit me 0.10 për litër qumësht të prodhuar, varet nga numri i aplikimit të fermerëve.

-
- Numri i kërkesave të fermerëve deri më tani që kanë aplikuar për kompenzim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore është 15, dhe planifikohet që të përkrahen të gjithë.
 - Projekti i DBZHR-së në bashkëfinancim me “Chatar Charity” për ngritjen e serrave të tipit Tunel me sipërfaqe 96 m² ku kanë qenë 44 përfitues (prodhues të perimeve), në vlerë **27,772.80€** është bartur në vitin 2026 si borxh i mbetur nga viti paraprak dhe është mbuluar nga buxheti i DBZHR-së.

III. Aktivitetet e bashkëpunimeve

- Memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Mitrovicës së Jugut dhe N.P.H. " Ibër-Lepenc" Sh.A për ujitjen e kulturave bujqësore në disa fshatra të Komunës së Mitrovicës së jugut.
- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është duke bashkëpunuar me MBZHR-në, drejtoritë komunale, organizatat vendore dhe ndërkombtare rreth realizimit dhe implementimit të projekteve në sektorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë edhe me Organiata qeveritare dhe joqeveritare të ndryshme si dhe me të gjitha institucionet relevante, për të qenë vazhdimisht në ofrimin e shërbimeve ndajë qytetarëve dhe fermerëve të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Disa foto nga aktivitetet e realizuara:



Aktiviteti i shpërndarjës së pajisjeve bujqësore nga "FAO", "UN Women" dhe financuar nga "ADA" dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut



Lokacione të Bletishteve në Zasellë dhe Lushtë



Vizita tek fermerët të sektorit të blegtorisë dhe perpunimit të pemëve dhe perimeve





Organizimi i Panairit një ditorë nga "FAO", "UN Women", "ADA" dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut

OBJEKTIVAT

Objektivat e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Komunës së Mitrovicës së Jugut janë në harmoni me objektivat dhe strategjinë zhvillimore të Republikës së Kosovës dhe në koherencë me prioritetet e bujqësisë dhe zhvillimit rural të rajonit dhe të BE-së:

- Edukimi i vazhdueshëm i fermerëve /Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Forcimi i zingjirit ushqimor, mbrojtja e prodhimeve bujqësore dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;
- Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve pëpunuese ushqimore në komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik të komunës përmes nxitjes së investimeve në fushat: pemëtari, perimtari, lavërtari, blegtori, bletari.

PERMBLEDHJE

Ky raport përmbledhë aktivitetet që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese gjashtëmujore zyrtarët e kësaj drejtorie kanë qenë të angazhuar dhe të gatshëm që t'ju dalin në ndihmë fermerëve për tejkalimin e lehtësimin e sfidave dhe telasheve të natyrave të ndryshme që kanë hasur fermerët gjatë veprimtarisë së tyre bujqësore duke ju ofruar këshilla dhe përkrahje pa hezitim.

17/07/2026

Mitrovicë e Jugut



Drejtore e DBZHR-së:

Remzije Tmava Tupella